

webertop finitura

Fino



■ Përshkrimi

webertop finitura është fino për shtresë përfundimtare me bazë çimento Portland, gëlqere të hidratuar dhe inerte të përzgjedhura. Produkt premium i pasuruar me fibra për të shmangur plasaritjet dhe lidhjen sa më të mirë me nënshtresën.

■ Avantazhet

- Dekorim dhe mbrojtje të sipërfaqeve vertikale
- Përgatitet dhe aplikohet lehtësisht
- Përdorim të brendshëm dhe të jashtëm

■ Përdorimi

webertop finitura përdoret në suvatimet e brendshme dhe të jashtme, mbi të gjitha llojet e sipërfaqeve tradicionale dhe të gjitha bazamenteve përthithëse. Nuk këshillohet përdorimi mbi bazamente të para lyera me bojë, bazamente druri, gipsi apo metali.

■ Përgatitja e bazamentit

- Temperatura e ajrit dhe bazamentit gjatë aplikimit dhe tharjes duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C
- Bazamenti ku do të aplikohet produkti duhet të jetë i fortë, i qëndrueshëm, i pastër dhe pa prani pluhuri apo mikroorganizmash.
- Në rastet e bazamenteve të vjetra, apo dhe llaçit tradicional, këshillohet që sipërfaqja të paratrajtohet me astarin / bazën e përshtatshme.
- Bazamenti duhet të njomet lehtësisht me ujë; në rast të bazamenteve shumë përthithëse

apo temperaturave të larta, duhet që bazamenti të njomet që një natë para aplikimit.

- Sipërfaqja e punës duhet të jetë e mbrojtur me rrjetë skelash nga impakti i drejtpërdrejtë i erës, diellit apo shiut, këshillohet të mos kryhen punime në kushte të rënda të motit

■ Udhëzime mbi aplikimin

- Përzjerja e produktit me ujë bëhet në një enë të pastër. Përmbajtja e thesit prej 25 kg përzjehet me anë të përzjerësit elektrik duke i shtuar gradualisht 7-7.5 litra ujë.
- Koha e përzjerjes nuk duhet t'i kalojë 3 minutat dhe përzjerja duhet të përdoret brenda 2 orësh.
- Aplikimi kryhet me mallë metalike në një ose dy shtresa, me trashësi maksimale 2 – 2,5 mm secila. Këshillohet që për aplikimin e shtresës së dytë, të pritët që shtresa e parë të ketë arritur tharjen e nevojshme për të mbajtur peshën shtesë.
- Kur sipërfaqja e materialit arrin tharjen e duhur, mbi të kalohet një bërda sfungjeri të njomë, për të arritur nivelimin përfundimtar të saj.

■ Veglat

- Për miksim: mikser elektrik
- Për aplikim: malle metalike

■ Jetëgjatësia

12 muaj, i magazinuar mbi paletë në zona të thata dhe pa ndikim të drejtpërdrejtë nga kushtet e motit. Duhet mbrojtur nga ngrica.

**Shënim: Të gjitha këto parametra janë të lidhura me kushtet standarde të motit, temperaturës 20°C dhe lagështisë relative deri në 65%. Në qoftë se kushtet e motit nuk janë në përputhje me procedurën e mësipërme është e nevojshme që të punohet për të përshtatur rrethanat. Weber garanton se cilësia e produkteve të dorëzuara përputhet me të gjitha normat dhe rregullat e prodhimit. Kompania nuk është përgjegjëse për gabime në aplikimin e këtij materiali, për përdorimin e materialit për qëllime jo të rekomanduara në përshkrimin e produktit, si dhe për aplikimin në kushte të tilla atmosferike që nuk janë në përputhje me specifikat në përshkrimin e produktit. Weber rekomandon që përpara fillimit të punës, të bëhet një test sipërfaqeje. Kompania pranon ankesa vetëm në cilësinë e produktit që mund të ketë qenë ruajtur, përgatitur dhe aplikuar sipas udhëzimeve të lëshuara. Informacioni i përfshirë në këtë fletë është rezultat i njohurive të disponueshme në datën e publikimit. Saint-Gobain Construction Products Albania nuk merr përgjegjësi për dëmtimin e personave ose të pronës që rezultojnë nga përdorimi i parregullt i këtij informacioni dhe rezervon të drejtën për të ndryshuar të dhënat pa paralajmërim.*



SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA sh.p.k

Rr. Budull, Nr.3 • 1039 Ahmetaq

Vore • Shqiperi

www.saint-gobain.com

NIPT : L61822023H

webertop finitura

Fino



Tabela e të dhënave teknike

Lloji i paketimit	thes letre	
Sasi për njësi	25 kg / thes 1350 kg / paletë	
Ngjyra	gri / bardhë	
Kokërrzimi	0.7 mm	
Konsumi	2,5-4.5 kg/m ²	Të dhënat mbi konsumin janë orientuese dhe në varësi të karakteristikave të bazamentit dhe teknikës së aplikimit.
Trashësia e shtresës	2-4 mm	

Treguesit fiziko-mekanikë

PARAMETRAT	VLERA MESATARE	NJËSIA MATËSE
Masa vëllimore në gjendje të shkrifët	1.2 -1.3	Gr/m ³
Mbetje ↓ 180 μ	45 - 50	%
Uje-mbajtja	97 - 100	%
Masa vëllimore e llaçit në 20 °C	1650 - 1750	Kg/L
Gjendja	Pluhur	

Treguesit kimikë

PARAMETRAT	VLERA MESATARE	NJËSIA MATËSE
Lagështira	0.1	%
Aditivë	0.3	%

*Shënim: Të gjitha këto parametra janë të lidhura me kushtet standarde të motit, temperaturës 20°C dhe lagështisë relative deri në 65%. Në qoftë se kushtet e motit nuk janë në përputhje me procedurën e mësipërme është e nevojshme që të punohet për të përshtatur rrethanat. Weber garanton se cilësia e produkteve të dorëzuar përputhet me të gjitha normat dhe rregullat e prodhimit. Kompania nuk është përgjegjëse për gabime në aplikimin e këtij materiali, për përdorimin e materialit për qëllime jo të rekomanduara në përshkrimin e produktit, si dhe për aplikimin në kushte të tilla atmosferike që nuk janë në përputhje me specifikat në përshkrimin e produktit. Weber rekomandon që përpara fillimit të punës, të bëhet një test sipërfaqeje. Kompania pranon ankesa vetëm në cilësinë e produktit që mund të ketë qenë ruajtur, përgatitur dhe aplikuar sipas udhëzimeve të lëshuara. Informacioni i përfshirë në këtë fletë është rezultat i njohurive të disponueshme në datën e publikimit. Saint-Gobain Construction Products Albania nuk merr përgjegjësi për dëmtimin e personave ose të pronës që rezultojnë nga përdorimi i parregullt i këtij informacioni dhe rezervon të drejtën për të ndryshuar të dhënat pa paralajmërim.



SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA sh.p.k

Rr. Budull, Nr.3 • 1039 Ahmetaq

Vore • Shqiperi

www.saint-gobain.com

NIPT : L61822023H